



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.280/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Skender Çoçaj kryesues, Arsim Hamzaj dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Violeta Salihu, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal të Prishtinës nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, parashtruar kunder komisionereve të Qendres së Numerimit QKN, në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 22.10.2025, merr këtë :

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZL.Anr.280/2025, e datës 20.10.2025, e parashtruar nga Violeta Salihu, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal të Prishtinës nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, parashtruar kunder komisionereve të Qendres së Numerimit QKN, në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 20.10.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën, ZL.Anr.280/2025, të datës 20.10.2025, e parashtruar nga Violeta Salihu, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal të Prishtinës nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilën thekson se kam dyshime të bazuara se gjatë procesit të numërimit të votave për kandidatët për Kuvendin Komunal në Qendrën e Numerimit dhe Rezultateve, përkatësisht në vendvotimet e shkollës “Emin Duraku” me kodin 1922/02, më mungojnë mbi dhjetë vota të cilat nuk janë pasqyruar në formular dhe në sistemin elektronik të KQZ-së. Tutje në ankesë thekson se në këtë vendvotim rezulton se kam marrë vetëm 2 vota të vlefshme, ndërkohë kam disa shoqëri dhe familjarë që e di me siguri se me kanë votuar në këtë klasë. Poashtu në ankesë parashtruesja thekson se dyshimi është përforcuar nga komisioneri zgjedhor Mentor Mehmeti, nga radhët e LDK-së, i cili ka qenë prezent gjatë procesit të numërimit dhe ka konfirmuar së në të njëjtin vendvotim kam pasur 14 vota të vlefshme. Parashtruesja e ankesës kërkon që duke marrë parasysh këto rrethana dyshoj se mund të ketë ndodhur një gabim, të urdhërohet KQZ për rinumërimin e votave në këtë qendër votimi.

Në përgjigjen në ankesë të datës 21.10.2025, Komisioni Qendror Zgjedhor kanë deklaruar se bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/ L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN.

Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN).

KQZ-ja, ju njofton se, rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZAP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimueshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre.

Pra, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LZP, pala mund të ushtrojnë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP,

Sa i përket pretendimeve të palëve ankuese që mbështeten në deklaratimet e familjarëve dhe miqve, duhet theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1,3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit,

KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, pas përfundimit të gjithë procesit të punës së QKN i njëjti material zgjedhor dorëzohet nga QKN në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë,

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë gjeti se:

-Ankesa është e pa bazuar.

Në bazë të shkresave të lëndës, përgjigjes së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Paneli vlerësoi se pretendimet ankimore të kandidatës për anëtare të Kuvendit Komunal të Prishtinës, Violeta Salihu, se gjatë procesit të numërimit të votave për kandidatët për Kuvendin Komunal në Qendrën e Numerimit dhe Rezultateve, përkatësisht në vendvotimet e shkollës “Emin Duraku” me kodin 1922/02, se i mungojnë mbi dhjetë vota të cilat nuk janë pasqyruar në formular dhe në sistemin elektronik të KQZ-së, dhe se në këtë vendvotim rezulton se ka marrë vetëm 2 vota të vlefshme, Paneli vlerëson se këto pretendime janë të pabazuara, për faktin se parashtresja e ankesës nuk ka ofruar asnjë provë konkrete për të vërtetuar këto pohime, edhe pse i është referuar parregullsive të supozuara në Qendrën e Komunale të Numerimit (QKN), në Prishtinë.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se *"PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht"* dhe Nenit 13 par. 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin në mënyrë decisive thuhet se: *"PZAP-i mund në përgjithësi të refuzoj një ankesë apo grup ankesash nëse ato nuk paraqesin raste prima facie ose ku ankesa apo grupi i ankesave është dukshëm i pabazë"*, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli ka vlerësuar se ankesa e paraqitur nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal të Prishtinës, Violeta Salihu, është e pabazuar, pasi pretendimi lidhur me mungesën e votave nuk është mbështetur me ndonjë provë materiale apo dokumentacion përkatës që do të vërtetonte se kandidates në fjalë i mungojnë votat, në vendvotimin e lartcekur.

Për rrjedhojë, në mungesë të provave konkrete, duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së në të cilin nen në mënyrë decisive se: *"Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse"*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë, parashtruesja e ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe nenin 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZLAnr.280/2025 më datën 22.10.2025

**Kryesues i Panelit,
Skender Çoçaj**

Prishtinë / Pristina

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.